



Republika e Kosovës
Republiko Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 09

Prishtinë, më 16 mars 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Armend Zemaj, Mufera Şinik, Kolë Berisha, Selvije Halimi dhe Radmila Vujović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Rinor Beka – NDI, Lumnije Murati - ZPRK, SW- Katrine Leica – ICO, Rob Nensone- US – Embessy, Luljeta Plakolli - Këshilli Evropës, Alban Sutaj - Ministria Drejtësisë, Saranda Stublla – “Fol”, Rrezarta Ahmeti – KDI, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 8 marsit 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
5. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

Para miratimit të rendit të ditës fjalën ia dha zonjës Radmila Vujović.

Radmila Vujović – I përshëndeti të pranishmit dhe uroi për zgjedhjet në Gjilan, edhe pse kjo nuk ishte pjesë e rendit të ditës dhe e debatit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 8 marsit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së 08 marsit 2010 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Projektligjit për Avokatin e Popullit

Kryetari - Lidhur me Projektligjin për Avokatin e Popullit tha se edhe në mbledhjen e kaluar ishte diskutuar a do të shqyrtohet në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi ose në Komisionin për të Drejtat e Njeriut. Meqë jemi përcaktuar ta shqyrtojmë, propozoj të mbahet një dëgjim publik dhe ta formojmë edhe një nënkomision, që do të punojë në shqyrtimin e Projektligjit. Do të kërkojmë nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut të na ndihmojë, qoftë me propozimamendamente ose me pjesëmarrje edhe në mbledhjet e Komisionit.

Adem Salihaj - Tha se nëse ka disponim nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut mund ta mbajmë një takim të përbashkët.

Armend Zemaj - U pajtua me parafolësit se si Komision mund të mbajmë takim të përbashkët me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, sepse disa nga anëtarët a atij Komisioni kanë marrë pjesë në përzgjedhjen e Avokatit të Popullit. Ishte i mendimit të formohet nënkomision dhe të mbahet dëgjimi publik në mënyrë që Projektligji të procedohet me kohë.

Kryetari – Propozoi që kryesues i nënkomisionit të jetë Bajram Kosumi, ndërsa anëtarë Ramadan Gashi dhe Kolë Berisha.

Bajram Kosumi – Pranoi të jetë kryesues i nënkomisionit, mirëpo kërkoi të zëvendësohet me njërin nga anëtarët e Komisionit, sepse ishte caktuar edhe në nënkomisionin e Projektkodit të drejtësisë për të mitur.

Kryetari - Propozoi që në vend të Bajram Kosumit, i caktuar në nënkomisionin për shqyrtimin e Projektkodit të drejtësisë për të mitur, të jetë Selviqe Halimi.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në shqyrtimin e Projektligjit për Avokatin e Popullit OSBE-ja të angazhojë ndonjë ekspert të jashtëm. Për këtë i mori shembull Shqipërinë dhe institucionin e Avokatit të Popullit. Në vazhdim i përmendi ekspertët e kësaj zyre ligjore, të cilët po të ftoheshin do të na ofronin përvojë të mirë. Theksoi se ky Projektligj, kështu si është, nuk parasheh asnjë mekanizëm, i cili e kërkon zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, siç e kanë vendet e tjera.

Meqë nuk pati vërejtje Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Të formohet nënkomisioni për shqyrtimin e Projektligjit për Avokatin e Popullit në këtë përbërje: Bajram Kosumi - kryesues, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli dhe Adem Hajdaraj - anëtarë.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryetari - E paraqiti Raportin me amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit për shqyrtim nga Komisioni. Në Raport parashihet se amendamentet 8, 10, 11, 17 dhe 29 të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi përmbajnë implikime buxhetore.

Armend Zemaj - Ofroi sqarime për amendamentin 2 të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Tha se ky është qëllimi ngase çdo e hyrë tatimohet dhe nuk ka nevojë të figurojë: *edhe pse është kompensim, tatimohet*. Me ligjin e ri do të përfshihen edhe shpenzimet e rrugës, të cilat nuk do të tatimohen.

Kryetari – Dha sqarime për amendamentin 3 të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe propozoi që të mbetet si në ligj.

Ibrahim Makolli - Duke iu referuar amendamentit 11 të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi tha se nuk do të duhej të kishte shumë përshkrime të funksioneve, sepse dihet se cilat janë funksionet parlamentare. Propozoi të riformulohej neni 18.1: *“Deputeti që mban funksione parlamentare merr kompensim shtesë, që përcaktohet me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe me vendim të Kuvendit.”*

Adem Salihaj – I krahasoi amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi me ato të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me nenin 18.1, që dallojnë thelbësisht. Amendamenti i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi i parashihet anëtarët e Kryesisë, kryetarët e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve, zëvendëskryetarët e komisioneve, por nuk i përfshin edhe anëtarët e komisioneve. Nëse është menduar për kompensim të veçantë, kjo është çështje tjetër. U pajtua që kompensimet të përcaktohen me vendim të Kuvendit.

Armend Zemaj – E sqaroi amendamentin 8, nenin 24.1, të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Shprehja: *“shërben kompensimi i deputetit”*, ndryshohet në shprehjen *“shërben paga bazë aktuale e deputetit”* dhe përqindja është ndryshuar nga “85” në “70 %”.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në amendamentin 10 të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në nenin 27.5: *“Përfshihet nga paragrafi 4 i këtij neni fëmijët e të cilit e vazhdojnë shkollimin do të përfitojnë deri në moshën 22-vjeçare.”* Propozoi që moshë “22-vjeçare” të zëvendësohet me “18-vjeçare”.

Armend Zemaj - Për amendamentin 13 të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se duke e marrë parasysh se në buxhetin e vitit 2010 nuk janë paraparë shpenzimet për pensionin suplementar, është

propozuar ky formulim, siç është në amendamentin 13. Është menduar edhe me rishikim të buxhetit, mirëpo në bashkëpunim me ministrin për ekonomi edhe financa nuk ka pasur mundësi të gjendet kosto shtesë për implementim të këtij ligji.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në amendamentin 13 të Komisionit për Buxhet dhe Financa fjalia: “pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” të hiqet.

Lidhur me amendamentin 13 të Komisionit për Buxhet dhe Financa, diskutuan edhe Adem Hajdaraj dhe Adem Salihaj. Komisioni vendosi që neni 56 i Projektligjit të riformulohet si vijon: “Ky ligj hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare, përjashtimisht neni 22, i cili fillon të zbatohet nga 1 janari 2011”.

Komisioni i përkrahu amendamentet: 1, 2, 5, 7, 8, neni 24.1, amendamentin 9, amendamentin 10, nenin 27.4, amendamentet 11 dhe 12, të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Komisioni nuk i përkrahu amendamentet: 3, 4, 6, amendamentin 8, nenin 24.2, amendamentin 10, nenin 27.5 dhe 13 të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kundër propozimit që të hiqet neni 27.5 ishte Adem Hajdaraj.

Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

5. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit V. B.

Komisioni lidhur me kërkesën e Avokatit V. B. për mbrojtje të lirisë së individit, konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni